

VENDIM
Nr. 87, datë 20.4.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2000 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.4.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 562/1 prot., datë 13.4.2022, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Korça Photovoltaic Park’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2000 kw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Korça Photovoltaic Park” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 450 prot., datë 4.4.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2000 kw.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal, dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhe lejet nga institucionet respektive. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin, si vijon:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gjerat: “a”, “b”, “c” dhe “g”, plotësuar;
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat “a” dhe “d”, plotësuar;
- Dokumentacionin teknik për centralin fotovoltaiik, neni 9, pika 4.4.2, pika 4.4.3, gjerat: “a”, “b”, “c” dhe “d” dhe pika 4.4.4, gjerat: “a”, “b”, “c” dhe “d”, plotësuar;
- Lejen nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.4.5, gjerat “a” dhe “b”, plotësuar;
- Në lidhje me dokumentacionin e munguar, që ka të bëjë me:

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “c” (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB-ja). Shoqëria duhet të depozitojë në ERE certifikatën e regjistrimit pranë QKB-së, si dhe ekstraktin historik të QKB-së, të lëshuar jo më vonë se një muaj përpara paraqitjes së aplikimit;

- germa “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë së qarkut Korçë për administratorin dhe shoqërinë “Korça Photovoltaic Park” sh.p.k., duke qenë se kjo e fundit ka seli vetëm në këtë qark;

- germa “f” (marrëveshje koncesioni apo çdo formë tjetër e marrëveshjes në rastet e aplikueshme, të lidhur me institucionet përgjegjëse të ngarkuara me ligj, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës si dhe ndryshim të këtyre akteve). Shoqëria duhet të përcjellë në ERE dokumentacionin përkatës (marrëveshjen/kontratën përkatëse me MIE-n), në vijim të miratimit të MIE-s nr. 885/4 prot., datë 11.3.2022;

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa “b” (bilanci financiar i tri viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë, shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit)). Shoqëria duhet të depozitojë në ERE pasqyrat financiare të vitit 2021;

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacione, të tjera)).

Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka vijuar me nënshkrimin e ndonjë kontrate kredie me bankën për të siguruar investimin dhe nëse po, ta dokumentojë në ERE, në kuadër të plotësimit të kërkesave të kësaj pike të rregullores, pasi vetëm shprehja e interesit e dokumentuar nuk mjafton për përmbushjen e tyre. Po ashtu do t’i kërkohej shoqërisë të bëjë me dije se si do të mbulojë 20 % të vlerës së investimit;

Dokumentacionin tekniko-ekonomik, neni 9, pika 4.4.1:

- Shoqëria duhet të plotësojë të dhënat për centralin prodhues dhe emrin e centralit, sipas kërkesave të formatit përkatës. Po ashtu, shoqëria ka vendosur si datë të fillimit të operimit datën 4.4.2022, ndërkohë që aplikimi i saj është paraqitur po në këtë datë në ERE dhe është ende në proces licencimi, ndaj do t’i kërkohej shoqërisë të bëjë saktësimet përkatëse. Gjithashtu do t’i kërkohej të bëjë saktësim edhe në lidhje me numrin e njërive gjeneruese, dhe kapacitetit të secilës, pasi nga të dhënat që ka përcjellë rezulton se 15 njësi x 175 kw është e barabartë me 2625 kw, çka kalon edhe kufirin +10% të kapacitetit prej 2000 kw, për të cilin kërkon të licencohet.

- Shoqëria duhet të bëjë me dije nëse ka filluar punimet apo fazën në të cilën ndodhen, si dhe të bëjë një përcaktim të qartë të viteve brenda të cilëve do të ndërtohet projekti, në kuptim të zbatimit të grafikut të punimeve.

- Në lidhje me dokumentacion pronësor (kontratat e qirasë) të depozituara nga shoqëria për territorin ku do të shtrihet projekti, do t’i kërkohej informacion/dokumentacioni përkatës nëse këto kontrata janë regjistruar në zyrat përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sikurse është përcaktuar në vetë dispozitat e këtyre kontratave, e po ashtu do t’i kërkohej saktësim i gabimeve të mundshme në referimin që i bëhet këtyre kontratave, në aktmarrëveshjet e lidhura në vijim të tyre.

- Duke qenë se nga dokumentacioni pronësor që subjekti ka depozituar në kuadër të licencimit, rezulton se numri i pasurisë së zonës ku do të shtrihet projekti është i ndryshëm nga ai i pasqyruar në VNM-në paraprake, shoqëria duhet të bëjë saktësimin përkatës.

- ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga studimi i fizibilitetit të centralit fotovoltai 2000 kw rezulton se jetëgjatësia e një paneli shkon 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Korça Photovoltaic Park” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 000 kw, në zonën Bitinckë – Bilisht, qarku Korçë, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti